



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian  
Mbledhja nr. 86

Prishtinë: Dt. 23.05.2024, në orën 9:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Rrezarta Krasniqi, Fjolla Ujkani, Fridon Lala, Agon Batusha, Alban Bajrami, Shqipe Isufi, Driton Hyseni dhe Time Kadrijaj.

**Munguan:** Elmi Reçica dhe Blerta Deliu-Kodra.

**Zyrtarët mbështetës të Komisionit:** Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

**Mbledhjen e kryesoi:** Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 16.05.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-277 për sport, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-264 për ririnë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-241 për vlerësimin strategjik mjedisor, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Të ndryshme.

## **1.Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 16.05.2024**

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-277 për sport, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja**, tha se ky projektligj ka për qëllim organizimin dhe zhvillimin e sportit dhe aktivitetit fizik në Republikën e Kosovës, në një ambient të sigurt, i cili promovon shëndetin dhe mirëqenien e sportistëve dhe shoqërisë në përgjithësi. Ndërsa, sa i përket përafrimit me legjislacion të BE-së, njoftoi se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacion të BE-së.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim Projektligjin, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional.

**Kryetarja** konstatoi, se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **Përfundim**

Projektligji nr.08/L-277 për sport, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

## **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-264 për rininë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja**, tha se qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i fushës së rinisë në nivel ndërinstitucional dhe ndërsektorial, duke e vendosur rininë në qendër të prioritetëve shtetërorë, me synim avancimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe të barabartë në procesin e vendimmarrjes, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve dhe të statusit të tyre shoqëror. Ndërsa, sa i përket përafrimit me legjislacion të BE-së, njoftoi se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacion të BE-së.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim Projektligjin, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional

**Kryetarja** pas votimit, konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **Përfundim**

Projektligji nr.08/L-264 për rininë, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend

### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja**, tha se qëllimi i këtij projektligji është krijimi, funksionimi, administrimi i regjistrit të pronarëve përfitues, përcaktimi i obligimeve të personave fizikë dhe subjekteve të detyruar të cilët regjistrojnë informacionin e pronësisë përfituese. Sa i përket përafrimit me legjislacion të BE-së, ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacion të BE-së

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim Projektligjin së bashku me amendamentet e Komisionit funksional

**Kryetarja** pas votimit, konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **Përfundim**

Projektligji nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

### **6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-241 për vlerësimin strategjik mjedisor, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja**, tha se ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të planeve dhe programeve, të iniciuara nga autoritetet lokale dhe qendrore për të siguruar nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe për të kontribuar në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, ndërsa, sa i përket përafrimit me legjislacion të BE-së, ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacion të BE-së.

**Kryetarja** hapi diskutimin dhe e hodhi në votim Projektligjin, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional

**Kryetarja** pas votimit, konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **Përfundim**

Projektligji nr.08/L-241 për vlerësimin strategjik mjedisor, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

**Të ndryshme.**

**Kryetarja** lidhur me këtë pikë, pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë ndonjë çështje për të ngritur.

**Fjolla Ujkani** propozoi që të shqyrtohet, Projektligji nr.08/L208 për ratifikimin e amendamentimit nr. 2 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2016 .

**Kryetarja** tha, se kur është miratuar rendi i ditës, ju nuk ishit prezent, prandaj tani në pikën të ndryshme, nuk mundet dhe duhet të ftohet Zv.kryeministri Besnik Bislimi, për ta prezantuar në Komision, në një mbledhje tjetër.

**Fjolla Ujkani** tha se z. Bislimi ishte i gatshëm në çdo kohë të vjen në komision, edhe sot ishte i gatshëm për raportim, prej orës 9:00, por ju kryetare thatë sot nuk bënë se është vonë me ja dërguar ftesën për sot, por për një ditë tjetër, andaj hidheni në votim propozimin tim.

**Kryetarja** e hodhi në votim propozimin e deputetes Ujkani dhe pas votimit, konstatoi se Komisioni miratoi propozimin dhe hapi debatin për shqyrtim dhe e hodhi në votim.

**Pas votimit, kryetarja konstatoi, se Komisioni miratoi Projektligjin nr.08/L208 për ratifikimin e amendamentimit nr. 2 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2016 .**

**Agon Batusha**, në lidhje me mbledhjen e fundit të COSAP, njoftoi anëtarët e komisionit se kërkesa e proceduar përmes Shqipërisë është refuzuar nga ana e Serbisë, kinse për çështje teknike , ku tha se ata ishin me bllokua Kosovën, që të anëtarësohet në COSAP me të drejta të plota dhe Shqipëria vendosi veto në Rezolutën e COSAC-ut. Është hera e parë që nuk ka deklaratë të përbashkët pas atij takimi. Andaj, sugjeroj që në COSAP ta kemi një delegacion të përhershëm përderisa të kryhet procedura e anëtarësimit dhe në të njëjtën kohë t'i dërgohet një letër Kryetarit të Parlamentit për ta njoftuar për destruktivitetin e Serbisë, e cila është në kundërshtim me Procesin e Berlinit, Marrëveshjen e Brukselit dhe me dakordanca të tjera. COSAP ka shumë probleme tjera edhe me Rregullore për shkak se Mali i zi dhe Serbia janë ende një shtet në Rregullore. Ne me Turqinë e kemi bërë kërkesën e përbashkët për anëtarësim dhe ka gjasa që edhe Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina bëjnë kërkesë për bashkëngjitje, kështu që komplet bëhet një paketë. Pasi ta njoftojmë Kryetarin e Kuvendit, ai pastaj me njoftua Kryeministrin dhe ne si Komision me njoftua Presidenten . Në të njëjtën kohë, Kryetari i Kuvendit pastaj këtë letër të Komisionit për Integrim me ua dërgua edhe ambasadave të shteteve anëtare të BE-së, për t'ju treguar për destruktivitetin e Serbisë, ku po bllokon bashkëpunimin rajonal të Komisioneve për Integrim Evropian, që kanë të bëjnë me BE-në. Pra, qëllimi

është me i njoftua dhe mos me e lënë në heshtje dhe juve si kryetare ju përket, që së bashku me Komisionin ti ndërmerrni hapat e tjerë.

**Kryetarja**, pajtohet për të bërë një shkresë për Kryetarin e Parlamentit, kurse për anëtarët e delegacionit, tha se unë jam gjithnjë dhe ju Agon keni marrë pjesë, mundemi me qenë nëse dakordohet grupi juaj.

**Agon Batusha**, tha se do te ishte mirë të ftohen të gjitha komisionet për Integritet Evropian të Turqisë, Moldavisë Gjeorgjisë dhe Ukrainës, të vijnë te ne në takim pune, të koordinohemi dhe pikërisht kërkesa jonë për anëtarësim të shkojë në bllok .

**Shqipe Isufi**, u ndërlidh me diskutimin e Agonit, lidhur me qasjen destruktive të Serbisë dhe pajtohet që mos të lihet në heshtje, ku dje, tha ishim dëshmitarë në takimin që e kishim, ku drejtorit të Agjencisë për CEFT-ën i erdh letra sa ishim aty, pikërisht me një qasje destruktive të Serbisë

Mbledhja përfundoi në orën 9:25.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

**Rrezarta Krasniqi,**

---

**Kryetare e Komisionit**